



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 11536 prot.

Tiranë, më 05.11. 2018

URDHËR

Nr. 739, datë 05.11. 2018

PËR
PËRCAKTIMIN E MËNYRËS DHE AFATIT TË DORËZIMIT TË
DOKUMENTACIONIT, SI DHE PËR PROCEDURAT E KONKURRIMIT PËR
POZICIONIN VAKANT TË OFICERIT TË SIGURISË

Në zbatim të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 600, datë 09.10.2018 “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”,

UDHËROJ:

1. Përcaktimin e mënyrës dhe afatit të dorëzimit të dokumentacionit, si dhe procedurat e konkurrimit për 150 vende vakante për oficerë sigurie në institucionet arsimore, sipas aneksit nr. 1 të Vendimit Nr. 600, datë 09.10.2018 të Këshillit të Ministrave dhe shtojcës 1 të shpalljes bashkëlidhur këtij urdhëri.
2. Publikimi i kriterëve dhe procedurat që do të ndiqen për konkurrimin, për pozicionin vakant të oficerit të sigurisë, të bëhet në ueb-in (web) zyrtar të MASR-së.
3. Paraqitja e dokumentacionit të kërkuar të bëhet në një nga mënyrat e përcaktuara në shpalljen bashkëlidhur këtij urdhëri, brenda datës 14.11.2018.
4. Verifikimi paraprak i dokumentacionit do të kryhet nga MASR nëpërmjet Zyrës së Koordinimit dhe Monitorimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Ministrinë e Brendshme “Për Oficerët e sigurisë në shkollat publike” nga data 15.11.2018 deri më datë 19.11.2018.
5. Lista e kandidatëve të kualifikuar për të vazhduar fazat e mëtejshme do të shpallet në ueb-in (web) zyrtar të MASR-së dhe çdo kandidat i kualifikuar/skualifikuar do të njoftohet me postë elektronike, brenda datës 20.11.2018.
6. MASR pas publikimit të kandidatëve të kualifikuar/skualifikuar, do të pranojë ankimimet nga data 21-23 nëntor 2018. Ankimimi do të bëhet në një nga mënyrat e përcaktuara në shpalljen bashkëlidhur këtij urdhëri.
7. Intervista e kandidatëve të kualifikuar do të bëhet nga grupi i punës i ngritur me urdhrin e përbashkët të MASR dhe MB. Intervista të kryhet sipas formatit të shtojcës 3 dhe kërkesave të përcaktuara në shpalljen bashkëlidhur dhe do të zhvillohet në datat 26.11.2018- 04.12.2018.

8. Shpallja e listës së kandidatëve të kualifikuar do të bëhet brenda datës 06.12.2018 në ueb-in (web) zyrtar të MASR-së.
9. Lista e kandidatëve të kualifikuar i përcillet Akademisë së Sigurisë për trajnimin mbi sigurinë në shkolla dhe certifikimin e tyre brenda datës 07.12.2018.
10. Akademia e Sigurisë, në përfundim të trajnimit realizon testimin e kandidatëve të trajnuar dhe bënë certifikimin e tyre. Lista e kandidatëve që përfundojnë me sukses këtë testim, të renditur sipas pikëve të fituara për çdo institucion arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, i përcillet zyrtarisht MASR-së.
11. Në muajin janar 2019, MASR do të dërgojë zyrtarisht emrat e kandidatëve fitues në çdo institucion arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, për të nënshkruar kontratat e punës, me të drejtë përzgjedhje të vendit të punës, duke filluar nga kandidati i renditur i pari për atë institucion arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar.
12. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Zyra e Koordinimit dhe Monitorimit, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

LINDITA NIKOLLA

